REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 857/20
Datë/Datum. 06-11-20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Emri dhe Mbiemri i eks. Shqyrtues dhe nënshkrimi	*Data e autorizimit të ekspertit*	*Data e dorëzimit të Raportit*	*Nr. i lëndës:*
Hysni Muhadri	27.10.2020	06.11.2020	857/20

NENI 105 i LPP-së, BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën:26.10.2020, OE "**Konaku Group shpk & NP Konaku" -** Drenas, ka parashtruar ankesë me nr: 857/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për dhënie të kontratës OE "NDËRTIMI ING & NPN ALPING" - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Palestra sportive - Skenderaj",** me nr.prok: **643-20-2900-5-2-1**, i iniciuar nga KK Skenderaj (KS).

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, punë, vlera e parashikuar e kontratës:200,000.00 €.

Data e njoftimit për kontratë.....10.07.2020.
Data e hapjes së ofertës.....30.07.2020.
Data e njoftimit mbi vendimin e AK-së.....14.10.2020.
Data e njoftimit si ofertues i papërgjegjshëm.....14.10.2020.
Data e kërkesës për rishqyrtim.....19.10.2020.
Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim:.....28.09.2020.

Nuk është e përsëritur ankesa.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

PRETENDIMET ANKIMORE DHE DISPOZITAT E SHKELURA

Dispozitat e shkelura sipas OE ankues "**Konaku Group shpk & NP Konaku**" - Drenas, janë:

Neni 1 – Qëllimi;
Neni 6 – Ekonomiciteti dhe Efikasiteti;
Neni 51 – Njoftimi i Kritereve të Përzgjedhjes;
Neni 52 – Njoftimi i kritereve për dhënien e kontratës;
Neni 59 – Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve;
Neni 69 – Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale;
Neni 72 – Dokumentacioni dhe informacioni shtesë;
Neni 39 – RRUOPP-së;
Neni 17 dhe 17.1 UA-MASHT. Nr.16/19.

DEKLARATA DETALE MBI FAKTET DHE ARGUMENTET:

1. **Pretendimi i AK, se nuk duhet të kërkohen informata sqaruese është i pa pranueshëm, për arsyet në vijim:**

AK, ka bërë shkelje të nenit 72 të LPP-së dhe shkelje të nenit 39, të RRUOPP sqarimi tenderëve, ku në vendimin e tij të datës 22.10.2020, pretendon se CV e dorëzuar nga OE, për menaxherin e projektit Ing. Mirsad Krrabaj nuk i përmbushe kërkesat e AK, dhe sipas tyre inxhinieri në fjalë nuk i ka 3 (tri) vite përvoje të punës. Zyra e prokurimit të Kuvendit Komunal të Skenderajt, i referohet tabelës se RRUOPP, përkatësisht kolonës 10, të nenit 39 të rregullores.

Ky pretendim është i pa pranueshëm, sepse AK, nuk e ka të qartë se kolona 10 e nenit 39 të RRUOPP, sqaron se: CV, refuzohet në ato raste kur, p.sh, është kërkuar ingjinier i profesionit të caktuar, ndërsa është ofruar ingjinier i profesionit tjetër, në këtë rast është ligjore që kërkesa të refuzohet, për arsye se është e pa mundur të ndryshohet profesioni edhe nëse kërkohen informata shtesë, ndërsa ne, kemi ofruar Ingjinierin adekuat sipas kërkesave të AK, me përjashtim që, CV e tij, nuk ka qenë e përditësuar me të dhëna vetëm sa i përket përvojës së punës, prandaj AK, është dashur të kërkoj patjetër informata shtesë, pikërisht duke u bazuar në paragrafin 1, të nenin 72 të LPP-së, dhe kolonës 12 të nenit 39, RRUOPP, sepse mund të kërkohen informata shtesë dhe, me sigurimin e këtyre informatave dhe dëshmive të ofruara nga OE, AK do merrte një ofertë me çmim shumë më të arsyeshëm, për me tepër ky është edhe qëllim primar i nenit 1 dhe 6 të LPP-së, shfrytëzimi sa me efikas dhe ma transparent i fondeve publike.

Ingjineri (menaxheri i projektit) ing. Mirsad Krrabaj, ka përvojë me shume se 4 (katër) vjeçare, nga qershori i vitit 2015 deri ne fund të prillit të vitit 2018, ka punuar në ndërmarrjen "ARBIN" shpk, dhe, pas përfundimit të punës në kompaninë në fjalë, Mirsad Krrabaj është angazhuar në kompaninë tonë që nga viti 2018 e tutje, me kontratë të rregullt pune.

Si dëshmi për këtë ofrojmë kontratën e punës dhe listën e pagave dhe kontributeve të deklaruara në ATK. Në datën e dorëzimit të dosjes se tenderit Mrsad Krrabaj ka mbi 4 (katër) vite përvoje të punës dhe kjo dëshmon se ky kriter përmbushet plotësisht nga Konsorciumi jonë.

2. **Pretendimi i AK, se para kontratat janë të mangëta për dy punëtor, është i pa pranueshëm për arsyet në vijim:**

AK, ka bërë shkelje të nenit 51 të LPP-së, të kriteret e përzgjedhjes, sepse në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit nuk është kërkuar kontrata apo para kontrata për 8 punëtor, por është kërkuar vetëm lista e punëtoreve teknik e nënshkruar dhe vulosur nga OE. Dhe, bazuar në këtë kërkese, ne, kemi ofruar listën e stafit teknik sipas kërkesave të AK.

Prandaj në këtë rast, AK nuk ka të drejtë të na eliminoi nga gara, sepse një kërkese e tillë nuk ka qene e parapara në dosje të tenderit dhe as në njoftimin për kontratë, në këtë rast AK bënë shkelje edhe të nenin 41.11 të RRUOPP, si dhe bën shkelje të nenit 7 dhe 69 të LPP-së.

3. **Pretendimi i AK, se gjeodeti, nuk posedon diplome nostrifikimi nga Minsitria e Arsimit, Shkencës dhe teknologjisë është i pa pranueshëm për arsyet në vijim:**

Gjeodeti Musa Ahmetaj, ka përfunduar fakultetin për gjeodezi ne vitin 1984 në Sarajevë dhe, që nga ajo kohë është ingjiner i diplomuar i gjeodezisë.

AK, **as në njoftimin për kontratë e as në dosje të tenderit** nuk e ka kërkuar një kërkesë të tillë, që diploma të jetë e nostrifikuar, kurse në vendimin e AK po citoj ...***diploma e gjeodetit Musa Ahmetaj e dorëzuar në ofertën tuaj, është e një shteti tjetër dhe nuk është e nostrifikuar nga organet kompetente në Kosovë***...., por, edhe nëse, AK do të kërkonte një kërkesë të tillë, ai është dashur të ketë parasysh edhe **UA (MASHT), nr. 16/2019**, *Parimet dhe procedurat e njohjes së diplomave, gradave dhe kualifikimeve të shkollave të larta profesionale dhe universitare të fituara jashtë Republikës së Kosovës.*

Për më tepër, Autoriteti Kontraktues, ka bërë shkelje të nenit 72 të LPP-së dhe nenit 39 të RRUOPP, sepse do duhej të kërkoj informata shtesë nga Institucionet Publike në këtë raste (MASHT), për tu pajisur me informatat e nevojshme ne pajtim me **UA (MASHT), nr. 16/2019.**

Ky udhëzim administrativ nr.16/2019, parasheh këtë situatë të njohjes së diplomave dhe gradave shkencore, prandaj ne po e citojmë nenin 17 të këtij udhëzimi:.... ***Këtij udhëzimi nuk i nënshtrohen njohja dhe barasvlera e diplomave/kualifikimeve*** dhe 17.1 citojmë: ***Të fituara/lëshuara nga institucionet e arsimit të lartë të cilat kanë funksionuar në territorin e ish-Jugosllavisë deri në vitin 1990.***

Bazuar në të gjitha të lartë cekurat, AK ka bërë shkelje të nenit 52 të LPP-së, për arsye së ne njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit, kriter i dhënies së kontratës ka qenë **çmimi më i ulët.**

Ne i plotësojmë të gjitha kriteret e përzgjedhjes sipas kërkesave të AK dhe, duhet të ishim fitues të kontratës

me çmim prej **146,910.00€**, sepse oferta jonë ka qenë me çmimin më të ulët, kurse AK (KK Skenderaj) ka shpërblyer me kontratë konsorciumin "Ndërtimi Ing" shpk, dhe "Alping" me çmim prej **164,837.15€**, me që rast do të dëmtohet buxheti i komunës në shumë prej **17,927.15€**.

Përfundim:

Kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik të Kosovës (OSHP), që ankesën tonë – konsorciumi **"KONAKU GROUP SH.P.K. & N.P "KONAKU"**, të **Aprovoj të bazuar**, të shqyrtoj të gjitha pretendimet tona, duke u mbështetur në provat, dokumentet dhe materialet e ofruara, **të anuloj vendimi e AK** për dhënie të kontratës dhe, lëndën ta kthej në **rivlerësim** sepse ka bazë dhe arsye të mjaftueshme që ne të shpallemi fitues të tenderit, për shkak se jemi **të përgjegjshëm** në pajtim me kriteret e përzgjedhjes dhe kemi ofruar **çmimin më të ulet** në pajtim me kriteret e vlerësimit.

Pretendimet ankimore të parashtruara në ankesën e deponuar në OSHP, nuk janë të njëjta me pretendimet e kërkesës për rishqyrtim.

FAKTET E RASTIT TË RËNDËSISHME PËR PRETENDIMET – KRITERET PËR VLERËSIM

III.2) KUSHTET PËR PJESËMARRJE

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë: Kërkesa 1. Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e specifikuara në nenin 65 te Ligjit të Prokurimit Publik (LPP), Ligji nr. 04 L-42. LPP mund të shkarkohet nga httpkrpp.rksgov.net. 2. Një vërtetim nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit 3. Një vërtetim i lëshuar nga Gjykata kompetente – ekonomike.	***Dëshmia e kërkuar dokumentare:*** *Dëshmia 1. Deklaratën nën betim se operatori ekonomik përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë Neni 65 i Ligjit Nr. 04 L-042 , - Plotësimi i Aneksit Nr. 2 te Dosjes se Tenderit.* *2. Një vërtetim nga Administrata Tatimore e vendit te themelimit te Operatorit Ekonomik, se Operatori Ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit (vlen për OE fitues).* *3. Një dokument nga Gjykata kompetente ku dëshmon se Operatori Ekonomik nuk është i falimentuar ose likuiduar (kërkohet origjinali ose kopja e vërtetuar, vlen për OE fitues).*
III.2.2) Përshtatshmëria profesionale: 1. Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit. 2. Certifikata për regjistrim në TVSH.	***Dëshmia e kërkuar dokumentare:*** *1. Certifikatës e biznesit - kopje.* *2. Certifikatës e TVSH-së - Kopje.*
III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar: 1. Operatori ekonomik duhet ti ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjatë tre viteve të fundit ka qenë prej jo më pak se 400,000.00 euro.	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* *1. Deklaratat vjetore tatimore te ATK-se për qarkullimin e kërkuar në tre vitet e fundit apo konfirmimin nga banka per qarkullimin e kërkuar.*

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesion Kërkesa 1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses të paktën një kontratë për punë të ngjashme në tri vitet e fundit nga data e publikimit te këtij njoftimi për kontratë. 2. a) Operatori Ekonomik të ketë një Menaxher të Projektit i cili duhet të jetë, bachelor apo inxhinier apo master i ndërtimtarisë drejtimi konstruktiv, min 3 vite përvojë pune. b) Një bachelor apo inxhinier apo master, drejtimi hidroteknik , me së paku 3 vite pervojë pune. c) Një bachelor apo inxhinier apo master, drejtimi i Arkitekturës , me së paku 3 vite pervojë pune. d) Një bachelor apo inxhinier apo master, drejtimi i Gjeodezisë , me së paku 3 vite pervojë pune. 3.Operatori Ekonomik për zbatimin e projektit të punëve, duhet të ketë minimum tetë (8) punëtorë.	***Dëshmia e kërkuar dokumentare:*** *Evidenca 1. Lista e kontratave të realizuara (përfunduara) të natyres se ngjajshme ne tri vitet e fundit nga data e publikimit te njoftimit për kontratë, të bashkangjitura me kopje te referencave raporteve te pranimeve.* *Dëshmi për kërkesat (a). (b). (c) dhe (d) - duhet dorëzuar kontratat për marrdhënje pune, kopjet e diplomave, referencat për përvojen e punës, CV-të dhe nëse nuk janë në listen e stafit profesional të kompanisë të kenë marrveshje për angazhim në këtë projekt.* *3. Lista e punëtorëve teknik - ndihmës duhet të jetë e nënshkruar dhe e vulosur nga OE, që dotë jenë të angazhuar në realizimin e punëve për të cilat ofertoni, së paku tetë (8) punëtorë.*

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:

Komisioni pasi ka analizuar ofertat, duke marr parasysh të gjitha kërkesat e FDT-së, për këtë lende, rekomandon ZP që fitues të shpallet OE "NDËRTIMI ING & NPN ALPING", me çmim të ofruar me vlerë: 164,837.15€.

Ky rekomandim i komisionit vlerësues është aprovuar dhe është bërë Njoftimi mbi vendimin e AK-së me 14.10.2020.

Operatori ekonomik ankues **"Konaku Group shpk & NP Konaku"** - Drenas, ka ofertuar në vlerë totale të ofertës:146,910.00€.

VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

VLERËSIMI I PRETENDIMEVE TË NDRYSHME TË ANKESËS SË OE "Konaku Group shpk & NP Konaku" – Drenas.

Përgjigje në Pretendimi nr. 1

Operatori ekonomik ankues "Konaku Group shpk & NP Konaku", është eleminuar për këto arsye, shihë më pohtë:

Oferta e juaj nuk ka dokumentacionin sipas kritereve të kërkuara ne Njoftimin per Kontrate dhe Dosjen e Tenderit, sepse Menaxheri i Projektit nuk permbushë kerkesen mbi pervojen e punes as ne CV dhe as ne Referenca, min. 3 vite siq eshte kerkuar ne Njoftimin per kontrate dhe DT, dhe sipas ***nenit 39 te RROUPP- se, CV-ja e dorezuar nuk permbush kerkesat – Refuzo tenderin pa kerkuar informacion te metejshem.*** *Gjithashtu tek punetoret e kerkuar gjithsej (8) mungojne te dhenat personale ne parakontrate per disa punetor. Poashtu diploma e e Gjeodetit eshte e nje shteti tjeter dhe nuk eshte e nostrifikuar ne organet kompetente ne Kosove.*

Eksperti shqyrtues konstaton se kërkesë e dosjes së tenderit dhe e njoftimit për kontratë është është: *"Operatori Ekonomik të ketë një Menaxher të Projektit i cili duhet të jetë, bachelor apo inxhinier apo master i ndërtimtarisë drejtimi konstruktiv, min 3 vite përvojë pune",* **dhe dëshmi dokumentare është** *"Dëshmi për kërkesat (a). (b). (c) dhe (d) - duhet dorëzuar kontratat për marrdhënje pune, kopjet e diplomave, referencat për përvojen e punës, CV-të dhe nëse nuk janë në listen e stafit profesional të kompanisë të kenë marrveshje për angazhim në këtë projekt".*

Operatori ekonomik ankues "Konaku Group shpk & NP Konaku", si si Menaxhet të projektit e ka ofruar, z. Mirsad (Faradin) Krrabaj, shihë Diplomën:

REPUBLIKA E KOSOVËS
UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"

REPUBLIC OF KOSOVO
UNIVERSITY OF PRISHTINA
"HASAN PRISHTINA"

FAKULTETI I NDËRTIMTARISË DHE ARKITEKTURËS NË PRISHTINË

FACULTY OF CIVIL ENGINEERING AND ARCHITECTURE IN PRISHTINA

Diplomë Diploma

MIRSAD FARIDIN KRRABAJ

U lind më 30.07.1988 në Dragash.
U regjistruar në viti akademik 2008/2009.
Studimet i kryerë më 15 korrik 2015 në:
DEPARTAMENTI I NDËRTIMTARISË
PROGRAMI STUDIMOR: KONSTRUKTIV
dhe mori titullin:
BACHELOR I NDËRTIMTARISË

Born on 30.07.1988 in Dragash.
Was enrolled in the academic year 2008/2009.
Completed his/her studies on 15 July 2015 in:
DEPARTMENT OF CIVIL ENGINEERING
STUDY PROGRAMME: CONSTRUCTION
and was awarded the title:
BACHELOR OF CIVIL ENGINEERING

Nivel i kualifikimit sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve: 6
Gjithsej 180 pikë - ECTS
Nota mesatare gjatë studimeve 7.03
Prishtinë, 24 korrik 2015

Level of qualification according to the National Qualifications Framework: 6
Total ECTS 180
Average grade of studies 7.03
Prishtina, 24 July 2015

Nr. 1186

Dekani / Dean
Prof. Asoc. Dr. Naser Kabashi

Rektori / Rector
Prof. Dr. Ramadan Zejnullahu

Ndërsa si dëshmi i ka ofruar CV dhe Referencën:

MIRSAD KRRABAJ

Curriculum Vitae

Të dhëna personale

Adresa dhe kontakti Holger Petersen LL-b-L-18
10 000 Prishtina,
Republika e Kosovës

Mob: +386 (0) 49 891 245
Email: mirsadkrrabaj@gmail.com

Datëlindja 30 Korrik 1988
Vendlindja Dragash
Gjinia Mashkull
Shtetësia Kosovar
Gjuhët e folura Gjuha mëmë shqipe, Anglisht bazike

Edukimi

Universiteti i Prishtinës
Bachelor I Ndërtimtarisë
Në përgatitje te temës së Mastrit te Ndërtimtarisë

Modulet kryesore Statika, Konstruksionet Metalike, Konstruksionet e Drurit, konstruksionet e Betonit, Matematika, etj.

Eksperienca

Qershor 2015 – Prill 2018 **"ARBIN" sh.p.k**
Mbikqyres I punimeve ne Objekt

Aftësitë

Komunikim
- Aftësi të shkëlqyera komunikuese
- Dëgjues i mire

Organizative dhe menaxheriale
- I gatshëm të punoj individualisht apo në grup
- Lidership
- I gatëshëm të punoj nën presion të lartë
- Zgjidhje e shpejtë e problemeve

Nderlidhja me profesion
- AutoCAD
- Tower

Kompjuterike
- Microsoft Office, Outlook
- Internet Explorer
- Windows 7, 8.1, 10

Referencat

Arbër Krrabaj ARBIN
Tel +377 (0) 44 967 184

Enis Ahmeti ProCredit Bank Kosovë
Tel +377 (0) 44 542 124

ARBIN

NGA: "Arbin" sh.p.k

PËR: Z. Mirsad Krrabaj

REFERENCË

I lëshoj këtë leter referencë në emër të biznesit "Arbin" sh.p.k
Unë Arbër Krrabaj vërtetoj se Z. Mirsad Krrabaj është i punësuar në biznesin tim nga data: 01.06.2015 - 30.04.2018

Me sukses ka permbushur detyrat dhe pergjegjesit për punët e kryera gjatë kësaj periudhe.

Biznesi është i kënaqur me saktesine e realizimit, profesionalizmin dhe përkushtimin që Z. Mirsad Krrabaj ka treguar ndaj çdo kërkese.

Data: 30.10.2018

Arbër Krrabaj

Drejtor

Eksperti shqyrtues konstaton se Menaxher të Projektit z. Mirsad (Faradin) Krrabaj inxhinieri i ndërtimtarisë drejtimi konstruktiv, nuk e plotëson përvojën e punës "min 3 vite përvojë pune", sepse siç shihet edhe në referencën e lëshuar nga kompania "ARBIN", SHPK, ky ka punuar nga dt:01.06.2015 deri me 30.04.2018, si dhe në CV e ofruar nuk figuron asnjë projekt i shënuar, që të kërkohet dëshmi shtesë për projektin në fjalë.

Përgjigje në Pretendimi nr. 2

Eksperti shqyrtues konstaton se në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit është kërkuar *"Operatori Ekonomik për zbatimin e projektit të punëve, duhet të ketë minimum tetë (8) punëtorë"*, tek **dështmit dokumentare është kërkuar:** *"Lista e punëtorëve teknik - ndihmës duhet të jetë e nënshkruar dhe e vulosur nga OE, që dotë jenë të angazhuar në realizimin e punëve për të cilat ofertoni, së paku tetë (8) punëtorë".*

Operatori ekonomik ankues në dosjen e tenderit e ka ofruar Listën e stafit prej gjitësejt 15 përsonave, ku tetë (8) nga ta janë punëtor teknik, dhe lista është konform kërkesës dë njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit, është e Vulosur dhe e nëshkruar nga OE, shihë Listë.

KONAKU

Adresa - Arllat - Drenas
Mobil: 049 215 791
E-mail: konakoilal@gmail.com

LISTA E PUNËTORVE

Nr.	Emri dhe mbiemri	Viti i lindjes	Pervoja e punës	Pozita
1	Metë Bytyqi	1972	10 vite	Drejtor
2	Florije Bytyqi	1975	5 vite	Menaxhere ne Administrate
3	Mirsad Krrabaj	1988	5 vite	Inxhinier i Ndertimtarisë
4	Bekim Zejneli	1980	8 vite	Inxhinier i Arkitekturës
5	Musa Ahmetaj	1956	20 vite	Inxhinier i Gjeodezisë
6	Rijad Zejneli	1988	5 vite	Inxhinier i Hidroteknikës
7	Rrahman Sefedini	1971	7 vite	Inxhinier i Emergjencave
8	Mahmut Bytyqi	1975	9 vite	Kryepuntor - Mjeshtër
9	Arif Bytyqi	1960	20 vite	Mjeshtër
10	Berat Gashi	1991	6 vite	Mjeshtër
11	Valdrin Bytyqi	1990	6 vite	Mjeshtër
12	Besmir Bytyqi	1991	6 vite	Puntor
13	Asdren Bytyqi	1999	3 vite	Puntor
14	Mergim Bytyqi	1996	4 vite	Puntor
15	Marigon Bytyqi	1995	5 vite	Puntor

Drenas, 2020

KONAKU GROUP SH.P.K.

SH.P.K. KONAKU GROUP Arllat

Përgjigje në Pretendimi nr. 3

Eksperti shqyrtues konstaton se kërkesë e dosjes së tenderit dhe e njoftimit për kontratë është është: "Një bachelor apo inxhinier apo master, drejtimi i Gjeodezisë , me së paku 3 vite pervojë pune", **dhe dështmi dokumentare është** *"Dështmi për kërkesat (a). (b). (c) dhe (d) - duhet dorëzuar kontratat për marrdhënje pune, kopjet e diplomave, referencat për përvojen e punës, CV-të dhe nëse nuk janë në listen e stafit profesional të kompanisë të kenë marrveshje për angazhim në këtë projekt".*

Operatori ekonomik ankues në dosjen e tenderit e ka ofruar ka ofruar Diplomën e inxhinierin të Gjeodezisë z. Musa Ahmetaj, të lëshuar nga Universiteti i Sarajevës, me dt:25.05.1984, ku kjo Diplomë është e noterizuar, dhe askun nuk është kërkuar të Nostrifikohet, shihë më poshtë:

SOCIJALISTIČKA FEDERATIVNA REPUBLIKA JUGOSLAVIJA
SOCIJALISTIČKA REPUBLIKA BOSNA I HERCEGOVINA

UNIVERZITET U SARAJEVU
GRAĐEVINSKI FAKULTET U SARAJEVU

DUPLIKAT

DIPLOMA

O ZAVRŠENOM STUDIJU ZA STICANJE VISOKE STRUČNE SPREME
NA GRAĐEVINSKOM FAKULTETU U SARAJEVU

REKTOR UNIVERZITETA I DEKAN GRAĐEVINSKOG FAKULTETA
UNIVERZITETA U SARAJEVU, PEČATOM UNIVERZITETA I
SVOJIM POTPISIMA POTVRĐUJU DA JE

Ahmetaj (Sadrija) Musa

ROĐEN 14. 02. 1956. GODINE U MJESTU CRNCE, OPŠTINA ISTOK, SOCIJALISTIČKA REPUBLIKA SRBIJA, ZAVRŠIO STUDIJ ZA STICANJE VIŠOKE STRUČNE SPREME, GEODETSKOG SMJERA, NA GRAĐEVINSKOM FAKULTETU U SARAJEVU, DANA 28.10.1983. GODINE I ISPUNIO SVE PROPISANE USLOVE ZA STICANJE DIPLOME O VISOKOJ STRUČNOJ SPREMI.

NA OSNOVU TOGA IZDAJE SE OVA DIPLOMA, KOJOM STIČE SVA PRAVA PREDVIĐENA ZAKONOM, KAO I STRUČNI NAZIV

DIPLOMIRANI GEODETSKI INŽENJER

U Sarajevu, 25. 05. 1984. godine

Broj: 72/83.

DEKAN
GRAĐEVINSKOG FAKULTETA

Doc. mr Faruk Selesković, s.r.

REKTOR
UNIVERZITETA U SARAJEVU

Prof. dr Boškar Matić, s.r.

UNIVERZITET U SARAJEVU

Broj: 0101-T-141/05

Datum: 11. 07. 2005.g.

Na osnovu člana 60. Pravila Univerziteta u Sarajevu izdaje se ovaj duplikat diplome koji u cjelosti odgovara originalnoj diplomi ovog fakulteta, izdatoj 25. 05. 1984. godine pod brojem 72/83.

DEKAN
GRAĐEVINSKOG FAKULTETA

Prof. dr. Muhamed Zlatar

REKTOR
UNIVERZITETA U SARAJEVU

Prof. dr. Hasan Muratović

Unë, notere Feraseta Pejcinovic, me seli në Pejë, Rr.Mbretëresha Teutë – Qendra Semitronix nr. 1,

Me kërkesë dhe në pranimë, **Z.Musa Ahmetaj**, i lindur me 14.02.1956 në Cerovë, identifikohet me letërnjoftimin e R.Kosovës me numër personal 1008883277 të lëshuar me 16.03.2016 pas krahasimit me dokumentin i cili me është prezantuar.

VËRTETOJ

/Se ky dokument është identik me origjinalin e dokumentit **"Diplomë" nr.72/83 të dt.25.05.1984** dhe dokumenti i ka gjithsej një fletë me një faqe të vlefshme.

Dokumenti i prezantuar është vërtetuar në një kopje.

Fotokopjimi sipas Ligjit është bërë në Zyrën time, ndërsa origjinali ndodhet të palë.
Në mbështetjen të nenit 43, pika 1. dhe 2, të Ligjit nr.03/L-010 "Për Noterin", të njëjtin e vërtetoj.
Tarifa Noteriale në shumë prej 1 euro + TVSH në vlerë prej 18% për 1 faqe, është paguar komfort nenit 27 të UA, Nr.02/2012, mbi Tarifat e përkohshme noteriale.

Në Pejë, me datë 17.10.2019 (shtatëmbëdhjetë tetor dymijë e nëntëmbëdhjetë)

LRP nr.3882/2019

NOTERE
Feraseta Pejcinovic

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK-së.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – Komuna e Skenderajt (KS).
- Panelit Shqyrtues – OSHP.
- OE ankues – "Konaku Group shpk & NP Konaku"